



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr.05, datë 26.07.2018

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR ZONËN E BULEVARDIT,
PARKUT QENDROR DHE LUMIT TË TIRANËS, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Bashkisë Tiranë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për zonën e Bulevardit, Parkut Qendror dhe Lumit të Tiranës, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues Bashkinë Tiranë.
2. Këtij Vendimi i bashkëlidhen si pjesë përbërëse:
 - a) Dokumenti i Manualit “Për miratimin e lejes së zhvillimit për zonën e Bulevardit, Parkut Qendror dhe Lumit të Tiranës”;
 - b) Harta e Përdorimit të propozuar të tokës;
 - c) Harta e Intensitetit të propozuar të ndërtimit;
 - d) Harta e Rrjetit rrugor të propozuar.
3. Procedurat administrative/ligjore për objektin e përmendur në pikën 1 të këtij Vendimi, do të vijohen nga Bashkia Tiranë, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në përputhje me marrëveshjen përkatëse për delegim kompetencash, bashkëlidhur këtij Vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Bashkia Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDHE RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



LEDIA TOTA